

# Njoftim aplikimi për bursë

Universiteti "A Xhuvani", Elbasan

Mbështetur në VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për Përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë",

## NJOFTON:

### I

**Studentët e viteve II – ta e të III – ta** në të gjitha programet e studimit bachelor me kohë të plotë, të cilët kanë qenë trajtuar me bursë një vit më parë, si dhe ata që kërkojnë të përfitojnë nga bursat e ndërmjetme në dispozicion të Universitetit, mund të aplikojnë për bursa për vitin akademik 2017-2018 duke paraqitur dokumentacionin sipas kriterëve të mëposhtme:

#### A-STUDENTËT NË NEVOJË, SIPAS KRITERIT EKONOMIK

**I- Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike**, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Vërtetim që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, ku të specifikohet masa e ndihmës ekonomike (vlera e shprehur me shifra dhe fjalë) – dokument origjinal lëshuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore.
- Vërtetim që studentit e ka vendbaminin e përheshëm të tij mbi 10 km larg nga Universiteti "A.Xhuvani" Elbasan. Ky vërtetim do të dorëzohet vetëm nga studentët që banojnë në Bashkinë Elbasan- dokument origjinal lëshuar nga Njësia Administrative e Bashkisë Elbasan.
- Kartë identiteti e studentit - *fotokopje*

**II- Studenti që rezulton bashkëshort me fëmijë dhe kur familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike**, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Vërtetim që familja e studentit bashkëshort trajtohet me ndihmë ekonomike, ku të specifikohet masa e ndihmës ekonomike (vlera e shprehur me shifra dhe fjalë) – dokument origjinal lëshuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore.
- Kartë identiteti e studentit – *fotokopje*

**III- Studentët që rezultojnë persona me aftësi të kufizuar**, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Vërtetim lëshuar nga KMPAC- dokument fotokopje e noterizuar ose e njehsuar me origjinalin.
- Vërtetim për përfitim të pagesës së aftësisë së kufizuar- dokument origjinal lëshuar nga institucioni përkatës.
- Kartë identiteti e studentit - *fotokopje*

*Mos dorëzimi i secilit dokument sipas të dhënave të kërkuara përbën shkak për skualifikim.*

**B-STUDENTËT NË NEVOJË, JASHTË KRITERIT EKONOMIK**, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Studentët që kanë përfitur statusin e jetimit – dokument fotokopje e noterizuar e statusit të jetimit;
- Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykatë të formës së prerë - fotokopje e noterizuar e vendimit të gjykatës;
- Studentët që janë identifikuar e trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror - fotokopje e noterizuar e vendimit të gjykatës;
- Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës - dokument origjinal lëshuar nga institucioni përkatës.

**Studentët e mësipërm duhet të paraqesin vetëm dokumentin e statusit që i përket (1 ose 2 ose 3 ose 4), si dhe :**

- Kartë identiteti e studentit - *fotokopje*

*Mos dorëzimi i secilit dokumenti sipas të dhënave të kërkuara përbën shkak për skualifikim.*

#### • STUDENTËT NUK PËRFITOJNË BURSË APO HUMBASIN TË DREJTËN E PËRFITIMIT NË RAST SE:

- janë ndarë nga trangu familjar
- familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private
- vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi.
- shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.
- nuk kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit.

**Dokumentacioni i përgatitur dhe i renditur sipas formularit të Aplikimit për bursë të dorëzohet nga vetë studentit në Rektorat nga data 08.11.2017 – 30.11.2017**

### II

**Studentët e viteve I- ra** në të gjitha programet e studimit bachelor me kohë të plotë, që përfitojnë bursë me Vendim Këshilli Bashkiak, të sjellin dokumentet:

- Llogari bankare Raiffeisen bank- *fotokopje*
- Kartë identiteti e studentit - *fotokopje*

**1. Formular aplikimi Bursë \_2017\_2018 viti Dytë e Tretë**  
**2. Dokumentacion plotësues për bursë Bachelor viti i parë 2017– 2018**  
shkarkohen nga faqja zyrtare e Universitetit "A. Xhuvani" Elbasan [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al)  
Njoftimi është i publikuar në adresën [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al)